



NË DEMOKRACI, E DREJTA E VOTËS I JEPET ÇDO QYTETARI

"Një ëndërr për të bërë një qytetar i mirë!!"



RËNDËSIA E KUVENDIT

SARANDA (13), ALTIN (13), LIRIM (13), HARIS (12), BLEART (13), DIJON (13), ENDRIT (12), BESIANA (13)



Artikulli më poshtë flet për Kuvendin dhe funksionet e tij

Paramendojeni një vend pa ligje. A do të kishte mundësi ai vend të funksiononte? Sigurisht që jo. Për ta kuptuar këtë më mirë, marrim shembull futbollin. Në këtë sport ka rregulla të caktuara që lojtarët duhet të ndjekin, në mënyrë që loja të funksionoj dhe të jetë sa më e drejtë. Pa këto rregulla, sigurisht se loja nuk do të mund të realizohej dhe do të krijohesh një kaos i vërtetë.

Prandaj, kemi rregulla në shtet, që ndryshe njihen si ligje. Një vend pa ligje do të ishte si të jetonim në errësirë dhe të bënim një jetë jo normale.

Falë ligjeve, ne ndihemi të mbrojtur dhe të sigurt. Nëse grupi ynë do të ishte një familje dhe nëse do të kishte një dyqan, sikur dikush të bënte vepër penale duke tentuar që produktin e dyqanit ta merrte fshehurazi, në rast se nuk do të kishim ligjet, atëherë ai person nuk do të dënohej. E shikoni se sa të rëndësishme janë ligjet? Po kaq i rëndësishëm është edhe vendi prej nga dalin ligjet, e që është Kuvendi.

Kuvendi ndryshe njihet edhe si Parlament. Këtë institucion të lartë demokratik mund ta quajmë „Shtëpia e Popullit“. Kjo për shkak se deputetët të cilët punojnë në Kuvend, zgjedhen nga ne, pra nga populli.

Ata gjithashtu kanë për detyrë të na përfaqësojnë neve në Kuvend. Kjo nënkupton se ata marrin vendime në emrin tonë.

Kuvendi ka shumë detyra të rëndësishme, por tri funksionet kryesore të këtij institucioni janë: funksioni leg-

jislativ, funksioni kontrollues dhe funksioni përfaqësues.

Kuvendi ka funksion legjislativ sepse bën miratimin ose jo miratimin e ligjeve. Kjo do të thotë se kur një projektligj shkon në Kuvend, deputetët me anë të votave bëjnë miratimin e atij projektligji. Për të kaluar një projektligj, duhet së paku 61 deputetë të votojnë pro. Kjo sepse në Kuvend janë 120 deputetë, ku 100 janë shqiptarë dhe 20 janë nga komunitetet jo shumicë. Kuvendi po ashtu kontrollon Qeverinë, prandaj themi se ka funksion kontrollues. Meqë ne përfaqësohemi në Kuvend nga deputetët, ata kanë funksion përfaqësues. Përpos këtyre funksioneve, Kuvendi gjithashtu zgjedh Presidentin, por edhe mund ta shkarkoj atë.

Kuvendin duhet ta shohim si pjesë tonën, sepse vërtet është pjesë e jona. Gjithçka që ndodh aty, bëhet me qëllim që ne të kemi jetë më të mirë. Për këtë punojnë deputetët.



Autorët e artikullit



E Shenjta Nëna Terezë, simboli i paqes dhe i dashurisë. Të bëhemi të gjithë si ajo



Deputetët janë shumë të rëndësishëm për të gjithë ne. Detyra e tyre është që të flasin në emrin tonë



„Demos-ti“, vendi ku u bëmë gazetarë për të parën herë

Mirëseardhët në pjesën e dytë të artikullit tonë. Kjo pjesë përmban informata rreth deputetëve dhe punës së tyre në Kuvend

Deputetët janë fjala jonë në Kuvend. Ne ua besojmë votat tona atyre. Një kandidat për deputet e shpalos planprogramin e tij gjatë kohës së fushatave zgjedhore. Qytetarët pasi e dëgjojnë planprogramin e kandidatëve, vendosin se cili planprogram u ka pëlqyer më shumë. Më pas atë kandidat e votojnë me shprehjen se ai do t'i mbajë të gjitha premtimet e tij dhe do të sigurojë një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët. Mandati i një deputeti zgjat 4 vjet. Për të kandiduar për deputet mundemi të gjithë ne, të cilët jemi mbi moshën 18 vjeçare. Këta kandidatë mund të jenë pjesë e ndonjë partie, por mund të jenë edhe të pavarur, që do të thotë se nuk bëjnë pjesë në ndonjë parti të caktuar. Ky ishte artikulli ynë me të gjitha informatat rreth Kuvendit. Si dhe mos e harroni se ne e bëmë demokracinë.



Qytetarët i zgjedhin deputetët

FËMIJËT DEMOKRATË

ARIANIT (13), ADEA (13), ELSA (12), ENDRIT (12), REDON (13), RINOS (13), ERDEN (12), FURKANE (12)




Demokracia është...

Sot, si pjesë e Punëtorisë së Demokracisë „Demos-ti“, jemi mbledhur për të zhvilluar disa aktivitete. Kemi marrë rolin e gazetarëve dhe gjithashtu kemi mësuar për demokracinë. Pasi ta përfundojmë këtë artikull, ne do ta vizitojmë Kuvendin ose Parlamentin e Kosovës, në mënyrë që të kemi më të qartë se si zhvillohet demokracia në vendin tonë.

Fjala demokraci përshkruan një nga format e qeverisjes. Ajo rrjedh nga greqishtja e vjetër, ku „demos“ nënkupton popullin dhe „kratia“ nënkupton pushtetin ose udhëheqjen. Kjo formë e udhëheqjes për herë të parë është shfaqur në Athinë, pra në Greqi, në vitin 507 para erës së re. Në atë kohë, vendin e kanë udhëhequr vetëm burrat e pasur me prejardhje nga Athina, ndërsa gratë dhe skllëvërit nuk e kishin këtë të drejtë. Në kohën e tashme udhëheqin burrat dhe gratë, duke gëzuar të drejta të barabarta. Disa të drejta në demokraci janë: e drejta e shprehjes së mendimit, e drejta e shkollimit, e drejta e familjes, e drejta e identitetit, etj. Çfarë do të ndodhte po të mos ishte demokracia? Të gjitha këto të drejta nuk do të respektoheshin. Marrim shembull, nëse s'do të kishim shkollën, do të kishim mbetur prapa, sepse s'do të dinim shkrim, lexim dhe kjo do të ndikonte në mos zhvillimin e shtetit. Nëse nuk do të kishim të drejtën e të shprehurit lirshëm, nuk do të mund t'i shprehnim mendimet tona dhe zëri i popullit nuk do të dëgjohej. Pastaj, vendi do të udhëhiqej nga një person që do të kishte cenzura në shumë sfera

të jetës, dhe si pasojë e kësaj, populli do të jetonte në një vend diktatorial. Mirëpo, demokracia nuk e lejon këtë gjë, sepse ne në demokraci kemi lirinë si element shumë të rëndësishëm. Mesazhi ynë është: shfrytëzoni të drejtat dhe lirinë, duke menduar për një të ardhme sa më të mirë të vendit.



Ne kemi të drejta të barabarta pavarësisht, racës, fesë gjinisë, etnicitetit, etj.



E ardhmja e vendit

QYTETARËT E KOSOVËS, QYTETARË AKTIV

ANDI (13), LEONITA (13), BLENDI (13), ELMAIDA (13), MUHAMED (13), ENDUENA (12), BLERONI (12),

DRENI (13)

Ne si qytetarë kemi të drejta të shumta, por gjithashtu kemi edhe përgjegjësi

Fjala qytetar përfshin çdo individ, i cili është pjesëtar i një shteti apo posedon leje qëndrimi në atë shtet. Çdo person kudo që jeton në botë është qytetar i shtetit të vet. Në demokraci, secili nga ne, për nga ligji ka të drejtat që i duhen. Disa nga të drejtat, të cilat çdo qytetar i ka janë: e drejta e shkollimit, e drejta e votimit, e drejta e argëtimit apo lojës, e drejta e identitetit, etj. Megjithatë, e drejta kryesore është e drejta e jetesës. Përveç të drejtave, qytetarët kanë përgjegjësi. Përgjegjësitë e një qytetari janë: të paguaj taksat, të zbatoj ligjin, të shkoj në shkollë, ta ruaj ambientin, etj.

E rëndësishme për një shtet demokratik është qytetaria aktive. Por, si mund të jetë një qytetar aktiv? Një qytetar mund të jetë aktiv duke marrë pjesë në organizata të ndryshme jo qeveritare, të protestojë në mënyrë paqësore, apo të jetë pjesë e ndonjë organizate, ku mbledhet një grup i individëve për ta pastruar ambientin, për të mbledhur fondacione të ndryshme për personat që kanë nevojë për ato fondacione, etj.


Një shembull konkret se si funksionon qytetaria aktive, jemi në nxënësit e shkollës „Zenel Hajdini“. Në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, së bashku me arsimtarin tonë e pastruam oborrin e shkollës.

Të dashur lexues të kësaj gazete, me këtë artikull duam që t'iu tregojmë të gjithë juve si qytetarë të Kosovës se ne duhet të jemi qytetarë aktiv, sepse kjo është për të mirën tonë dhe të gjithë popullit.

Ne ju falenderojmë që e lexuat artikullin tonë dhe asnjëherë mos i harroni këshillat tona.



Një shembull i qytetarisë aktive. Të bëhemi të gjithë aktiv për të mirën e vendit tonë



Përgjegjësia jonë është ta mbajmë ambientin pastër



Gazetarët e Kosovës



Duke vizatuar një punim për artikullin



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
 REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
 REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
 Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
 Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
 TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
 Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“
 E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-6
 Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë